

V E N D I M
Nr. 590, datë 2.11.2000

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.222, DATË 24.5.1997, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES ME KONCESION, TË FORMËS
“BOT”, PËR HIDROCENTRALIN E KALIVAÇIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995, “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë“, me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe të ministrit të Punëve Publike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.222. datë 24.5.1997, të Këshillit të Ministrave, pas pikës 1 shtohet pika 1/a, me këtë përmbajtje:

“Miratohet aneksmarrëveshja, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi, e lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Shoqërisë B.E.G, s.p.a, Itali, për ndërtimin e hidrocentralit të Kalivaçit, me koncesion, të formës BOT.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

**ANEKS MARRËVESHJE PËR DISA NDRYSHIME TË MARRËVESHJES ME
KONCESION TË FORMËS BOT PËR HIDROCENTRALIN E KALIVAÇIT**

1. Në nenin 1 “Përcaktim”, të Marrëveshjes së Koncesionit, të ndryshohet emërtimi i dhënë për “Organin Shtetëror të Autorizuar” dhe të bëhet Ministria Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministria e Punëve Publike.

2. Në nenin 1 “Përcaktim”, të Marrëveshjes së Koncesionit, të shtohet termi “Shoqëri e kontrolluar”, që është çdo shoqëri që kontrollohet nga Koncesionari, sipas përcaktimeve të bëra në bazë të nenit 219 të Ligjit nr.7638, datë 19.11.1992, “Për shoqëritë tregtare”.

3. Në nenin 13 të Marrëveshjes së Koncesionit të shtohet “Objekti i këtij Koncesioni mund të realizohet, menaxhohet dhe mirëmbahet nga Koncesionari ose nga një shoqëri e kontrolluar prej tij. Në këtë kuptim në qoftë se Koncesionari vepron nëpërmjet një shoqërie koncesionare të kontrolluar prej tij, Koncesionari mbetet përgjegjës ndaj Organit Shtetëror të Autorizuar për të gjithë detyrimet që përmbahen në Marrëveshjen e Koncesionit”.

4. Në nenin 34 të Marrëveshjes së Koncesionit të hiqet paragrafi “Një aprovim i tillë të përcaktohet brenda 60 ditëve prej nënshkrimit të Marrëveshjes aktuale të Koncesionit”.